



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit
dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 dhjetor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave

**Ushtruesit të detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave
Ushtrueses së detyrës së Shefit të ZPV-së

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIME	4
A.	ZPV.....	4
B.	Mbrojtja e Thaçit.....	5
C.	Mbrojtja e Veselit.....	6
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	7
A.	PARASHTRIMI I KËRKESËS DHE PRANIMI NË PROCES.....	7
B.	Pjesëmarrja në procedurën paraprake	8
C.	Masat mbrojtëse	9
IV.	ÇËSHTJE PARAPRAKE.....	10
V.	DISKUTIM	10
A.	Vlerësimi i kërkesave në Raportin e Katërt të Zyrës Administrative.....	11
1.	Plotësia e kërkesave	11
2.	Pranueshmëria e kërkesave	11
3.	Përfundim.....	15
B.	Vlerësimi i kërkesave në Raportin e Pestë të Zyrës Administrative	15
1.	Plotësia e kërkesave	15
2.	Pranueshmëria e kërkesave	16
3.	Përfundim.....	23
C.	Masat mbrojtëse	23
D.	Grupimi dhe përfaqësimi ligjor i përbashkët.....	29
E.	Pjesëmarrja në procedurën paraprake	31
F.	Udhëzime për mbrojtësin e viktimave.....	31
G.	Zgjatja e afatit për leje për apelim.....	31
VI.	VENDIM.....	32

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenet 22, 39(11) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 80, 95(2)(h) dhe (i), 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi² aktakuzën kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht “të akuzuarit” ose “Mbrojtja”) (“Aktakuza e Konfirmuar”).³

2. Më 4 janar 2021 dhe 6 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat” (“Vendimi i Parë Kornizë”) dhe “Vendimin e Dytë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat”, duke përcaktuar, rrjedhimisht, parimet që rregullojnë procesin e pranimit të viktimave për pjesëmarrje në proces.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës Kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u nxor më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED, dhe versioni i redaktuar publik më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale. Një version i korigjuar më tej i aktakuzës së konfirmuar që korigjoi disa gabime shtypi u dorëzua më 4 nëntor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00045/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00045/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00045/A03). Versioni i redaktuar konfidencial me më pak redakte u dorëzua më 11 dhjetor 2020 (F00134). Versioni i korigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Versioni konfidencial me edhe më pak redakte i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 17 janar 2022, F00647/A01.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 4 janar 2021, publik; F00382, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat* (“Vendimi i Dytë Kornizë”), 6 korrik 2021, publik.

3. Më 21 prill 2021, 10 dhjetor 2021 dhe 25 maj 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin e parë, të dytë dhe të tretë mbi pjesëmarrjen e viktimave duke pranuar 32 viktima për pjesëmarrje në proces dhe duke refuzuar tetë kërkesa, (përkatësisht “Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”, “Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave” dhe “Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”).⁵

4. Më 25 janar 2022, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (“ZPV”) dorëzoi raportin e katërt në lidhje me kërkesat e viktimave, duke dorëzuar 16 kërkesa (“Raporti i Katërt i Zyrës Administrative”).⁶

5. Më 10 shkurt 2022, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) paraqiti përgjigjen ndaj Raportit të Katërt të Zyrës Administrative (“Përgjigjja e Thaçit”).⁷

6. Më 29 prill 2022, pasi Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi ndryshimin e akuzave,⁸ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi aktakuzën e ndryshuar (“Aktakuza e Ndryshuar”).⁹

⁵ KSC-BC-2020-06, F00257, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 21 prill 2021, konfidencial, para. 85(a), (f). Versioni i redaktuar publik u nxor më të njëjtën ditë, F00257/RED; F00611, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 10 dhjetor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 70(a)-(c). Versioni i redaktuar dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më të njëjtën ditë, F00611/CONF/RED dhe F00611/RED; F00817, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 25 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 50(a). Versioni i redaktuar publik u nxor më të njëjtën ditë, F00817/RED.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00656, ZPV, *Raporti i Katërt i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 25 janar 2022, publik, me Shtojcat 1-17, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00685, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Raportit të Katërt të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 10 shkurt 2022, publik.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 185. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F00777/CONF/RED. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2022, F00777/RED.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00789/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Ndryshuar*, 29 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzuan më të njëjtën ditë, përkatësisht F00789/A02 dhe F00789/A05. Pas vendimit që autorizoi ndryshimet shtesë të akuzave, një version me ndryshime të mëtejshme në aktakuzë u parashtrua më 30 shtator 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00999/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00999/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00999/A03).

7. Më 22 korrik 2022, ZPV-ja dorëzoi raportin e pestë në lidhje me kërkesat e viktimave, duke dorëzuar 25 kërkesa (“Raporti i Pestë i Zyrës Administrative”).¹⁰

8. Më 4 gusht 2022, Mbrojtja e z. Veseli (“Mbrojtja e Veselit”) paraqiti përgjigje ndaj Raportit të Pestë të Zyrës Administrative (“Përgjigjja e Veselit”).¹¹

9. Më 15 shtator 2022, pasi Mbrojtja e Veselit apeloj Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave,¹² Gjykata e Apelit konfirmoi standardin ligjor të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që zbatohet për miratimin e masave mbrojtëse (“Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Masat Mbrojtëse”).¹³

II. PARASHTRIME

A. ZPV

10. Në Raportin e Katërt të Zyrës Administrative, ZPV-ja i vlerëson si të plota, por të papranueshme, kërkesat e parashtruara nga viktimat 23/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06 dhe 69/06, sepse asnjë nga krimet që parashtruesit e kërkesave pretendojnë të kenë qenë viktimat nuk përfshihet në akuzat e konfirmuara, të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar.¹⁴ Rrjedhimisht, ZPV-ja i rekomandon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të refuzojë të gjitha kërkesat për pjesëmarrje si viktimë në proces¹⁵

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00894, ZPV, *Raporti i Pestë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 22 korrik 2022, publik, me Shtojcat 1-26, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00916, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Raportit të Pestë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces (F00894)*, 4 gusht 2022, publik.

¹² KSC-BC-2020-06, IA023/F00002, Mbrojtësi i Specializuar, *Apel i Ndërmjetëm i Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 12 korrik 2022, publik.

¹³ KSC-BC-2020-06, IA023/F00006, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 15 shtator 2022, publik, para. 32, 52-52. Versioni i korrigjuar u dorëzua më të njëjtën ditë, IA023/F00006/COR.

¹⁴ Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para.2, 13, 20, 29, 31; Shtojca 1 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

¹⁵ Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para. 43.

dhe nuk bën rekomandime lidhur me grupime dhe përfaqësim ligjor të përbashkët.¹⁶ Së fundi, ZPV-ja propozon që emrat dhe të dhënat identifikuese të të gjithë parashtruesve të kërkesave të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut.¹⁷

11. Në Raportin e Pestë të Zyrës Administrative, ZPV-ja i vlerëson si të plota kërkesat e parashtruara për pjesëmarrje në proces nga viktimat 24/06, 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 70/06, 71/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 81/06, 82/06, 83/06, 84/06, 85/06, 86/06 dhe 87/06.¹⁸ ZPV-ja i rekomandon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të pranojë 21 parashtrues të kërkesave si viktima pjesëmarrëse dhe të refuzojë katër parashtrues të kërkesave, sepse krimet prej të cilave ata pretendojnë të kenë qenë viktima nuk përfshihen në akuzat e konfirmuara, të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar.¹⁹ ZPV-ja gjithashtu rekomandon që 21 parashtruesit e kërkesave të grupohen me viktimat tashmë të pranuar me qëllim përfaqësimin ligjor të përbashkët dhe të përfaqësohen prej mbrojtësit të viktimave të caktuar.²⁰ Së fundi, ZPV-ja propozon që t'u miratohet anonimiteti të gjithë parashtruesve të kërkesave që rekomandohen të pranohen si viktimë pjesëmarrëse në proces dhe të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut emrat dhe të dhënat identifikuese të të gjithë parashtruesve të kërkesave që rekomandohen të refuzohen si viktimë pjesëmarrëse në proces.²¹

B. MBROJTJA E THAÇIT

12. Në lidhje me Raportin e Katërt të Zyrës Administrative, Mbrojtja e Thaçit përgjigjet se i përkrah rekomandimet e ZPV-së për refuzimin e 16 kërkesave për

¹⁶ Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para. 44.

¹⁷ Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para. 47.

¹⁸ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para.2, 18, 21; Shtojca 1 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

¹⁹ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 56-57; Shtojca 1 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

²⁰ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 63.

²¹ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 69-72.

pjesëmarrje në proces si viktimë,²² sepse parashtruesit e kërkesave nuk kanë treguar mjaftueshëm, *prima facie*, se ngjarjet e përshkruara në kërkesat e tyre përfshihen në parametrat materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të konfirmuara.²³

C. MBROJTJA E VESELIT

13. Në lidhje me Raportin e Pestë të Zyrës Administrative, Mbrojtja e Veselit përgjigjet se nuk kundërshton pranueshmërinë e viktimave që rekomandohen për pjesëmarrje në proces, por i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që t'u refuzojë anonimitetin të gjitha viktimave dhe të kufizojë masat mbrojtëse sipas instrumentit ligjor të Dhomave të Specializuara ("DHS").²⁴ Mbrojtja e Veselit parashtron se anonimiteti i plotë nuk është masë mbrojtëse ligjërishit e vlefshme për viktimat pjesëmarrëse në proces dhe se, në kohën e paraqitjes së parashtrimit, është nën shqyrtim prej Gjykatës së Apelit.²⁵ Rrjedhimisht, ajo i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të shtyjë marrjen e vendimit deri kur Gjykata e Apelit të nxjerrë vendimin e vet.²⁶ Si alternativë, Mbrojtja e Veselit kërkon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) të refuzojë rekomandimet e ZPV-së lidhur me masat mbrojtëse në Raportin e Pestë të Zyrës Administrative; dhe/ose (ii) të urdhërojë ZPV-në që të japë informacion lidhur me aspekte të sigurisë me të cilat përballet secili prej parashtruesve të kërkesave, sepse ZPV-ja nuk ka arritur të kryejë vlerësim të hollësishëm të rrezikut për secilin parashtrues të kërkesës për pjesëmarrje në proces si viktimë dhe rekomandimet nuk mbështeten nga faktet.²⁷

²² Përgjigjja e Thaçit, para. 1, 23.

²³ Përgjigjja e Thaçit, para. 16, 22.

²⁴ Përgjigjja e Veselit, para. 1, 14.

²⁵ Përgjigjja e Veselit, para. 5, 14.

²⁶ Përgjigjja e Veselit, para. 5, 14.

²⁷ Përgjigjja e Veselit, para. 7-14.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARASHTRIMI I KËRKESËS DHE PRANIMI NË PROCES

14. Sipas nenit 22(1) të Ligjit dhe rregullës 2 të Rregullores, viktimë është person fizik që ka pësuar personalisht dëm fizik, mendor apo material, si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

15. Sipas rregullës 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një veprë penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces, ku saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve.

16. Sipas rregullës 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon Gjykatësit të Procedurës Paraprake së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit. ZPV-ja duhet t'u dorëzojë duhet t'u dorëzojë edhe një raport konfidencial palëve, pa nxjerrë të dhëna identifikuese të parashtruesve të kërkesave.

17. Sipas rregullës 113(3) të Rregullores, palët mund të bëjnë parashtrime vetëm në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

18. Sipas rregullës 95(2)(i) dhe 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një veprë penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos edhe për

përfaqësimin e përbashkët, si dhe për çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

19. Sipas rregullës 113(6) të Rregullores, personat të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh pas njoftimit të vendimit.²⁸

20. Sipas rregullës 113(8) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pasi konsultohet me ZPV-në, vendos nëse viktimat pjesëmarrëse në proces do të ndahen në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh: (a) konfliktet e interesave që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët; (b) interesat e ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët; dhe (c) të drejtat e të akuzuarit dhe interesat për një gjykim të drejtë e të shpejtë.

B. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

21. Në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit, interesi personal dhe të drejtat e viktimave në procese penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.

22. Në pajtim me rregullën 113(7) të Rregullores, kur viktimave u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në proces, grupit të viktimave pjesëmarrëse në proces Administratori i cakton një mbrojtës të viktimave në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit.

23. Në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(1) të Rregullores, viktimat pjesëmarrëse në proces i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes një mbrojtësi të viktimave që u caktohet, ndër të tjera gjatë procedurës paraprake, kur preken interesat personale të tyre dhe vetëm kur kjo nuk cenon apo nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.

24. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxjerr udhëzime të posaçme

²⁸ *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA005/F00003, Gjykata e Apelit, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtëses për Sqarim dhe Ndryshim të Afatit, 31 maj 2021, publik, f. 3.*

që rregullojnë pjesëmarrjen e viktimave pjesëmarrëse në proces në fazën e procedurës paraprake, në pajtim me nenin 22(3) dhe (6) të Ligjit.

25. Në pajtim me rregullën 114(2) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të arsyeshme, me qëllim garantimin e interesave personale dhe të drejtave të viktimave pjesëmarrëse në proces, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

26. Në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në materiale konfidenciale, përveç nëse Rregullorja parashikon ndryshe, ose sipas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht klientët për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione konfidenciale.

27. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, kurdoherë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues, bën parashtrime me gojë dhe me shkrim.

C. MASAT MBROJTËSE

28. Në pajtim me nenin 39(11) të Ligjit dhe rregullën 95(2)(h) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, mund të marrë vendime mbi mocionet në lidhje me mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe të dëshmitarëve, të paraqitura përpara kalimit të dosjes gjyqësore trupit gjykues.

29. Në pajtim me rregullën 80(1) të Rregullores, një panel, *proprio motu* ose me kërkesë, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë, ndër të tjera, të viktimave pjesëmarrëse në procese.

30. Në pajtim me rregullën 80(4) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë mosnxjerrjen për palët të materialit apo informacionit që mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.

IV. ÇËSHTJE PARAPRAKE

31. Në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për shtyrjen e marrjes së vendimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me kërkesën e ZPV-së për anonimitet,²⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se Gjykata e Apelit ndërkohë ka nxjerrë vendimin e vet.³⁰ Rrjedhimisht, kjo kërkesë është e tejkaluar dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë Raportin e Pestë të Zyrës Administrative në tërësi.

V. DISKUTIM

32. Gjatë vlerësimit të 41 kërkesave të parashtruara për pjesëmarrje si viktimë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në Vendimin e Parë Kornizë dhe Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në lidhje me kriteret që një kërkesë të konsiderohet e plotë,³¹ kriteret e pranueshmërisë,³² standardin e vërtetimit,³³ kriteret ligjore që zbatohen për miratimin e masave mbrojtëse³⁴ dhe kriteret për ndarjen në grupe të viktimave për përfaqësimin e përbashkët ligjor të tyre.³⁵

²⁹ Përgjigja e Veselit, para. 5, 14.

³⁰ *Shih më lart*, para. 9.

³¹ Vendimi i Parë Kornizë, para. 22; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 34.

³² Vendimi i Parë Kornizë, para. 28, 30-39; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 42, 45, 50-55.

³³ Vendimi i Parë Kornizë, para. 29; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43.

³⁴ Vendimi i Parë Kornizë, para. 45-49; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 64, 67.

³⁵ Vendimi i Parë Kornizë, para. 42-44 (*shih gjithashtu* para. 27, 40-41, 44, dhe 49, lidhur me rolin e ZPV-së në kryerjen e vlerësimit paraprak për pranueshmërinë, grupimin dhe masat mbrojtëse)); Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76.

A. VLERËSIMI I KËRKESAVE NË RAPORTIN E KATËRT TË ZYRËS ADMINISTRATIVE

1. Plotësia e kërkesave

33. Pasi ka shqyrtuar formularët e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin e Parë Kornizë,³⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të gjithë formularët e kërkesave janë të plotë.³⁷

2. Pranueshmëria e kërkesave

34. *Person fizik.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të gjithë parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje në proces si viktimë, janë persona fizikë.³⁸

35. *Krimet e pretenduara.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, siç është konfirmuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, krimet prej të cilave një parashtrues kërkesë pretendon se është viktimë, duhet të jenë brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar.³⁹ Për kryerjen e këtij vlerësimi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton raportet e ZPV-së, formularët e kërkesës, dokumentacionin mbështetës dhe pjesët përkatëse të Aktakuzës së Ndryshuar, të cilat janë pika referimi për analizën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe duhen lexuar së bashku me arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Ndonëse çdo kërkesë vlerësohet individualisht, për mundësimin e zhvillimit të shpejtë dhe efikas të procesit, ky vlerësim nuk nënkupton domosdoshmërisht dhënien e arsyetimeve të veçanta për secilin parashtrues kërkesë, sidomos kur arsyet janë të njëjta ose të ngjashme.⁴⁰

³⁶ *Shih* Vendimi i Parë Kornizë, para. 22.

³⁷ *Shih gjithashtu* Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para. 20.

³⁸ Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para. 24.

³⁹ KSC-BC-2020-06, IA005/F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin kundër "Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"* ("Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"), 16 July 2021, publik, para. 35; Vendimi i Parë Kornizë, para. 32; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 61.

⁴⁰ *Shih* Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 61.

36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se asnjë prej parashtruesve të kërkesave në Raportin e Katërt të Zyrës Administrative nuk ka treguar *prima facie*, se krimet prej të cilave pretendojnë të kenë qenë viktima, përfshihen në kuadrin kohor, gjeografik dhe material të akuzave që paraqiten në Aktakuzën e Ndryshuar, dhe rrjedhimisht nuk përfshihen në fushëveprimin e rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores.⁴¹ Më konkretisht:

- (a) **Viktima 23/06** pretendon se në [REDAKTUAR], anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) morën anëtarin e familjes së tij të ngushtë nga shtëpia e tyre në [REDAKTUAR].⁴² **Viktimat 30/06 dhe 31/06** pretendojnë se anëtari i familjes së ngushtë të tyre u pa për herë të fundit në [REDAKTUAR] dhe se anëtarë të UÇK-së e morën dhe e çuan në një vend të panjohur në [REDAKTUAR].⁴³ **Viktima 32/06** pretendon se, në [REDAKTUAR], burra të veshur me uniforma të UÇK-së morën anëtarin e familjes së saj të ngushtë nga [REDAKTUAR] dhe e çuan në një vend të panjohur.⁴⁴ **Viktima 48/06** pretendon se, në [REDAKTUAR], anëtari i familjes së tij të ngushtë u mor nga [REDAKTUAR] dhe u çua në një vend të panjohur, që besohet se ishte kamp i UÇK-së në atë zonë.⁴⁵ **Viktimat 50/06 dhe 51/06** pretendojnë se, në [REDAKTUAR], burra me uniforma të UÇK-së morën anëtarë të familjes së tyre të ngushtë nga [REDAKTUAR] dhe i çuan në një vend të panjohur.⁴⁶ **Viktimat 60/06, 61/06 dhe 62/06** pretendojnë

⁴¹ Raporti i Katërt i Zyrës Administrative, para. 43; Shtojcat 2-17 të Raportit të Katërt të Zyrës Administrative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, megjithëse ZPV-ja i referohet Aktakuzës së Konfirmuar të Korrigjuar, ai ka vlerësuar të gjitha kërkesat në kontekst të Aktakuzës së Konfirmuar.

⁴² Viktima 23/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 2 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁴³ Viktima 30/06, Formulari i Kërkesës; SD3-Përmbledhje në anglishte e informacionit shtesë; Viktima 31/06, Formulari i Kërkesës; Shtojcat 4-5 të Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁴⁴ Viktima 32/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 6 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁴⁵ Viktima 48/06, Formulari i Kërkesës; SD3-Letër përcjellëse nga avokati; Shtojca 9 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁴⁶ Viktima 50/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 51/06, Formulari i Kërkesës; Shtojcat 11-12 të Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

se anëtari i familjes së tyre të ngushtë u mor në [REDAKTUAR].⁴⁷ Vendndodhja e anëtarëve të familjes së ngushtë të viktimave 23/06, 30/06, 31/06, 32/06, 48/06, 50/06, 51/06, 60/06, 61/06 dhe 62/06 mbetet e panjohur edhe sot e kësaj dite.⁴⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se: (i) informacioni i dhënë është i pamjaftueshëm për një konstatim *prima facie* se viktimat e drejtpërdrejta u mbajtën në një nga qendrat e ndalimit të identifikuar në Aktakuzën e Ndryshuar;⁴⁹ (ii) viktimat e drejtpërdrejta nuk janë në mesin e viktimave të pretenduara të vrasjes së paligjshme ose zhdukjes me forcë të përmendur me emër në Aktakuzën e Ndryshuar;⁵⁰ dhe (iii) në lidhje me pretendimet e viktimave 60/06, 61/06 dhe 62/06, informacioni nuk mjafton për konstatim *prima facie* se anëtarë të UÇK-së morën viktimën e drejtpërdrejtë.

(b) **Viktimat 29/06 dhe 43/06** pretendojnë se anëtarë të familjes së tyre të ngushtë u vranë nga anëtarë të UÇK-së në [REDAKTUAR].⁵¹ **Viktima 52/06** pretendon se anëtari i familjes së saj të ngushtë u vra nga anëtarë të UÇK-së në [REDAKTUAR].⁵² **Viktima 69/06** pretendon se anëtari i familjes së tij të ngushtë u vra nga një grup [REDAKTUAR]/anëtarë të UÇK-së në

⁴⁷ Viktima 60/06, Formulari i Kërkesës; SD4-Shënim në Dosje; Viktima 61/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 62/06, Formulari i Kërkesës; Shtojcat 14-16 të Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁴⁸ Viktima 23/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 30/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 31/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 32/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 48/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 50/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 51/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 60/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 61/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 62/06, Formulari i Kërkesës; Shtojcat 2, 4-6, 9, 11-12, 14-16 të Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁴⁹ *Shih* Aktakuza e Ndryshuar, para. 61-95; Lista A.

⁵⁰ *Shih* Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës* ("Vendimi mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës"), 22 korrik 2021, konfidencial, para. 159-161, 171. Versioni i redaktuar publik u nxor më të njëjtën ditë, F00413/RED; Aktakuza e Ndryshuar, para. 138-175; Lista B; Lista C.

⁵¹ Viktima 29/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 43/06, Formulari i Kërkesës; Shtojcat 3, 8 të Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁵² Viktima 52/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 13 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

[REDAKTUAR].⁵³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se: (i) viktimat e drejtpërdrejta nuk janë ndër viktimat e pretenduara të vrasjes së paligjshme ose të zhdukjes me forcë të përmendura me emër në Aktakuzën e Ndryshuar;⁵⁴ dhe (ii) pretendimi i viktimës 52/06 gjithashtu nuk përfshihet në kuadrin kohor të Aktakuzës së Ndryshuar.⁵⁵

- (c) **Viktima 42/06** pretendon se anëtarë të familjes së saj të ngushtë u morën nga [REDAKTUAR] dhe u çuan në një kamp të UÇK-së në [REDAKTUAR]. Kufoma e viktimës së drejtpërdrejtë u identifikua në [REDAKTUAR].⁵⁶ **Viktima 49/06** pretendon se anëtari i familjes së saj të ngushtë u mor nga [REDAKTUAR] dhe u çua në një nga kampet e UÇK-së në [REDAKTUAR] ku u torturua dhe u vra. Kufoma e viktimës së drejtpërdrejtë u gjet në [REDAKTUAR] dhe u identifikua në [REDAKTUAR].⁵⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se: (i) [REDAKTUAR] nuk figuron si vend krimi në Aktakuzën e Ndryshuar;⁵⁸ (ii) informacioni i dhënë nuk mjafton për konstatim *prima facie* se anëtari i familjes së viktimës 49/06 u mbajt në një nga qendrat e ndalimit të identifikuar në Aktakuzën e Ndryshuar; dhe (iii) viktimat e drejtpërdrejta nuk janë ndër viktimat e pretenduara të vrasjes së paligjshme dhe të zhdukjes me forcë të përmendura me emër në Aktakuzën e Ndryshuar.⁵⁹

⁵³ Viktima 69/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 17 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, megjithëse Shtojca 17 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative përmend vetëm [REDAKTUAR], Formulari i Kërkesës i Viktimës 69/06 përmend “anëtarë të UÇK-së”.

⁵⁴ Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendim mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 159-161, 171; Aktakuza e Ndryshuar, para. 138-175; Lista B; Lista C.

⁵⁵ *Shih* Aktakuza e Ndryshuar, para. 16.

⁵⁶ Viktima 42/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 7 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁵⁷ Viktima 49/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 10 e Raportit të Katërt të Zyrës Administrative.

⁵⁸ *Shih* Aktakuza e Ndryshuar, para. 61-95; Lista A.

⁵⁹ Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendimi mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 159-161, 171; Aktakuza e Ndryshuar, para. 138-175; Lista B; Lista C.

37. Konstatimet e mësipërme nuk paragjykojnë kërkesat dhe vendime të ardhshme mbi pranueshmërinë e tyre, në rast të ndryshimit të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar. Kriteret e tjera të pranueshmërisë nuk do të vlerësohen në lidhje me këta parashtrues të kërkesave.

3. Përfundim

38. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 23/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06 dhe 69/06, për arsyet e paraqitura në paragrafin 36, nuk pranohen si viktima pjesëmarrëse në proces.

B. VLERËSIMI I KËRKESAVE NË RAPORTIN E PESTË TË ZYRËS ADMINISTRATIVE

1. Plotësia e kërkesave

39. Pasi ka shqyrtuar formularët e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Parë Kornizë,⁶⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të gjitha kërkesat janë të plota.⁶¹ Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se disa dokumente mbështetëse nuk janë të disponueshme në anglishte,⁶² ose nuk mund të lexohen,⁶³ dhe udhëzon ZPV-në që, në të ardhmen, të dorëzojë përkthimet në anglishte ose versione të lexueshme të të gjitha dokumenteve mbështetëse.

⁶⁰ *Shih* Vendimi i Parë Kornizë, para. 22.

⁶¹ *Shih gjithashtu* Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, megjithëse viktimat 63/06, 64/06, 65/05, 66/06, 67/06, 68/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 84/06, 85/06, 86/06 nuk kanë dorëzuar dokumentacion në lidhje me dëmin e pësuar, përshkrimet e hollësishme që ata ofruan mjaftojnë për të arritur në konstatimet përkatëse.

⁶² *Shih, për shembull*, Viktima 70/06, SD2-Recetë nga mjeku; Viktima 81/06, SD2-Raport mjekësor; Viktima 82/06, SD3-Vërtetime mjekësor, SD4-Kërkesë pronësore dhe për banim, SD5-Vendim për dhënien në shfrytëzim të banesës, SD7-Artikull nga gazeta; Viktima 85/06, SD3-Certifikatë e Vdekjes.

⁶³ *Shih, për shembull*, Viktima 71/06, SD4-Dokumentacion mjekësor, Viktima 85/06, SD3-Certifikatë e Vdekjes; SD4-Dokument pronësor.

2. Pranueshmëria e kërkesave

40. *Person fizik*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të gjithë parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje në proces si viktimë, janë persona fizikë.⁶⁴

41. *Krimet e pretenduara*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet gjithashtu se 21 nga parashtruesit e kërkesave janë viktimë të krimeve që pretendohet se u kryen në vendndodhje të identifikuar në Aktakuzën e Ndryshuar dhe se krimet e pretenduara përfshihen brenda kuadrit kohor të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar në lidhje me secilën nga vendndodhjet.⁶⁵ Më konkretisht:

- (a) **Viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06 dhe 68/06** janë viktimë jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] kundër një anëtarit të familjes së ngushtë, të përmendur me emër si viktimë në Aktakuzën e Ndryshuar.⁶⁶
- (b) **Viktima 70/06** është viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor e torturës që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR].⁶⁷
- (c) **Viktima 71/06** është viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor e torturës që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR].⁶⁸

⁶⁴ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 25.

⁶⁵ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 28.

⁶⁶ Viktima 63/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 64/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 65/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 66/06, Formulari i Kërkesës, SD3- Certifikatë e Vdekjes, SD4-Mesazh elektronik (E-mail); Viktima 67/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 68/06, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojcat 2-7 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁶⁷ Viktima 70/06, Formulari i Kërkesës; SD2-Recetë nga mjeku; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 8 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁶⁸ Viktima 71/06, Formulari i Kërkesës; SD3-Photo; SD4-Dokumentacion mjekësor; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 9 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

- (d) **Viktima 72/06** është viktimë jo e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR] kundër një anëtari të familjes së ngushtë të përmendur me emër si viktimë në Aktakuzën e Ndryshuar.⁶⁹
- (e) **Viktima 73/06** është viktimë e drejtpërdrejtë e ndalimit të paligjshëm dhe akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR].⁷⁰
- (f) **Viktimat 74/06, 77/06 dhe 84/06** janë viktimat jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] kundër një anëtari të familjes së ngushtë të përmendur me emër si viktimë në Aktakuzën e Ndryshuar.⁷¹
- (g) **Viktima 75/06** është viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor dhe torturës që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR].⁷²
- (h) **Viktima 76/06** është viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor dhe torturës që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR].⁷³

⁶⁹ Viktima 72/06, Formulari i Kërkesës, SD2-Certifikatë e Vdekjes; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 10 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁷⁰ Viktima 73/06, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 11 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁷¹ Viktima 74/06, Formulari i Kërkesës; SD3- Certifikatë e Vdekjes; Viktima 77/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 84/06, Formulari i Kërkesës; SD4-Shënim në dosje; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojcat 12, 15, 20 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁷² Viktima 75/06, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 13 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁷³ Viktima 76/06, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 14 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

- (i) **Viktimat 78/06, 79/06 dhe 80/06** janë viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] kundër një anëtari të familjes së ngushtë që përmendet me emër si viktimë në Aktakuzën e Ndryshuar.⁷⁴
- (j) **Viktima 82/06** është viktimë e drejtpërdrejtë dhe jo e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR] kundër tij dhe anëtarëve të familjes së ngushtë.⁷⁵
- (k) **Viktimat 85/06 dhe 86/06** janë viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar që pretendohet se u kryen në [REDAKTUAR] kundër një anëtari të familjes së ngushtë.⁷⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktimat 85/06 dhe 86/06 pretendojnë gjithashtu se janë viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme dhe/ose zhdukjes me forcë të dy anëtarëve të familjes së ngushtë, por konstaton se, meqë anëtarët e familjes së ngushtë nuk janë ndër viktimat e vrasjes së paligjshme ose zhdukjes me forcë të

⁷⁴ Viktima 56/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 78/06, Formulari i Kërkesës; SD4-/Certifikatë në lidhje me Kufomën; SD5-Vërtetim i shkakut të vdekjes; SD6-Vërtetim i ADN-së; SD7-Vërtetim i identifikimit; Viktima 79/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 80/06, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojcat 16-18 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, megjithëse viktimat 78/06, 79/06 dhe 80/06 nuk përmenden [REDAKTUAR], anëtari i familjes së tyre të ngushtë përmendet me emër si viktimë në këtë vendndodhje në Aktakuzën e Ndryshuar.

⁷⁵ Viktima 82/06, Formulari i Kërkesës; SD3-Vërtetim mjekësor; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojca 19 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁷⁶ Viktima 85/06, Formulari i Kërkesës; SD6-Përshkrim i ngjarjes; Viktima 86/06, Formulari i Kërkesës; Aktakuza e Ndryshuar, [REDAKTUAR]; Shtojcat 21-22 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

përmendura me emër në Aktakuzën e Ndryshuar, krimi i pretenduar nuk përfshihet në kuadër të akuzave.⁷⁷

42. Sa u përket **viktimave 24/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06**, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se këto viktima nuk kanë treguar *prima facie*, se krimet prej të cilave pretendojnë të kenë qenë viktima, përfshihen në kuadrin kohor, gjeografik dhe material të akuzave, të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar, dhe rrjedhimisht nuk përfshihen në fushëveprimin e rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores. Më konkretisht:

(a) **Viktima 24/06** pretendon se në [REDAKTUAR], anëtarë të UÇK-së morën anëtarin e familjes së saj të ngushtë nga [REDAKTUAR] dhe e çuan në një vendndodhje të panjohur.⁷⁸ Vendndodhja e tij mbetet e panjohur sot e kësaj dite.⁷⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se: (i) informacioni i dhënë nuk mjafton për konstatim, *prima facie*, se viktima e drejtpërdrejtë u mbajt në një nga qendrat e ndalimit të identifikuara në Aktakuzën e Ndryshuar;⁸⁰ dhe (ii) viktima e drejtpërdrejtë nuk është ndër viktimat e pretenduara të vrasjes së paligjshme ose të zhdukjes me forcë të përmendura me emër në Aktakuzën e Ndryshuar.⁸¹

(b) **Viktima 81/06** pretendon se një grup burrash hynë me dhunë në shtëpinë e familjes së tij në [REDAKTUAR] dhe vranë anëtarë të familjes së tij të ngushtë në [REDAKTUAR].⁸² **Viktima 83/06** pretendon se anëtarë të

⁷⁷ Viktima 85/06, Formulari i Kërkesës; SD6- Përshkrim i ngjarjeve; SD6-Shënim në dosje; Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendimi mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 159-161, 171; Aktakuza e Ndryshuar, para. 138-175; Lista B; Lista C.

⁷⁸ Viktima 24/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 23 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁷⁹ Viktima 24/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 23 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁸⁰ *Shih* Aktakuza e Ndryshuar, para. 61-95; Lista A.

⁸¹ Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendimi mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 159-161, 171; Aktakuza e Ndryshuar, para. 138-175; Lista B; Lista C.

⁸² Shtojca 24 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se ZPV-ja nuk ka paraqitur përkthimin në anglishte të formularit të kërkesës të viktimitës 81/06's Formulari i Kërkesës. Për hir të efikasitetit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë konstatimin mbi

familjes së tij të ngushtë u vranë në [REDAKTUAR] nga luftëtarë të UÇK-së në [REDAKTUAR].⁸³ **Viktima 87/06** pretendon se anëtari i familjes së tij të ngushtë u vra në [REDAKTUAR] nga një grup burrash nga [REDAKTUAR].⁸⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se: (i) viktimat e drejtpërdrejta nuk janë ndër viktimat e pretenduara të vrasjes së paligjshme dhe të zhdukjes me forcë, të përmendura me emër në Aktakuzën e Ndryshuar;⁸⁵ dhe (ii) nuk ka informacion të mjaftueshëm për një konstatim, mbi bazën *prima facie*, se anëtarët e familjes së viktimave 81/06 dhe 87/06 u vranë nga anëtarë të UÇK-së.

43. Konstatimet e mësipërme nuk paragjykojnë kërkesat e ardhshme dhe vendimet mbi pranueshmërinë e tyre, në rast të ndryshimit të akuzave kundër të akuzuarve të paraqitura në Aktakuzën e Ndryshuar. Kriteret e tjera të pranueshmërisë nuk do të vlerësohen në lidhje me këta parashtrues të kërkesave.

44. *Dëmi*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të gjithë parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje si viktimë në proces kanë pësuar, *prima facie*, dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të përshkruara nga ata, si më poshtë:

- (a) **Viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 72/06, 74/06, 78/06, 79/06, 80/06, 84/06, 85/06 dhe 86/06**, si anëtarë të familjes së ngushtë, personalisht kanë pësuar dëm mendor (traumë psikologjike, çrregullim të stresit pastraumatik, pikëllim të thellë, depresion, frikë, ankth, stres dhe pagjumësi) si rezultat i drejtpërdrejtë i dëmit që pretendohet të kenë pësuar viktimat e drejtpërdrejta.⁸⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, ndonëse

bazën e Shtojcës 24 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake udhëzon ZPV-në që në të ardhmen të dorëzojë përkthimet në anglishte.

⁸³ Viktima 83/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 25 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative

⁸⁴ Viktima 87/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 26 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁸⁵ *Shih* Aktakuza e Ndryshuar, para. 138-175; Lista B; Lista C.

⁸⁶ Viktima 63/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 64/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 65/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 66/06, Formulari i Kërkesës; SD4-Mesazh elektronik (E-mail); Viktima 67/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 68/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 72/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 74/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 78/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 79/06, Formulari i

viktimat 78/06 dhe 80/06 pretendojnë se kanë pësuar gjithashtu dëm fizik (tension të lartë të gjakut dhe dhimbje koke)⁸⁷ si anëtarë të familjes së ngushtë të viktimës së drejtpërdrejtë, ai gjykon se informacioni dhe dokumentacioni i dhënë nuk mjaftojnë për konstatim *prima facie* se dëmi fizik i pësuar nga viktimat 78/06 dhe 80/06 është rezultat i drejtpërdrejtë i dëmit të shkaktuar ndaj anëtarit të familjes së tyre të ngushtë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktimat 85/06 dhe 86/06 gjithashtu pretendojnë dëm material⁸⁸ por gjykon se informacioni dhe materiali i dhënë nuk mjaftojnë për konstatim *prima facie* se dëmi material i përshkruar që pësuan këto viktima është rezultat i drejtpërdrejtë i dëmit të shkaktuar ndaj anëtarit të familjes së tyre të ngushtë.

(b) **Viktimat 70/06, 71/06, 73/06, 76/06 dhe 82/06** kanë pësuar personalisht dëm fizik (shenja lëndimesh, lëndim nofulle, dhimbje fizike dhe thonj të shkullur) dhe dëm mendor (depresion, ankth, sulme paniku, makth, kujtime të ngjarjeve të shkuara dhe stres), si rezultat i drejtpërdrejtë i ndalimit dhe keqtrajtimit të tyre të pretenduar.⁸⁹ Viktimat 71/06, 76/06 dhe 82/06 kanë pësuar gjithashtu dëm material si rezultat i drejtpërdrejtë i ndalimit dhe keqtrajtimit të pretenduar.⁹⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se

Kërkesës; Viktima 80/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 84/06, Formulari i Kërkesës; SD4-Shënim në dosje; Viktima 85/06, Formulari i Kërkesës; SD6-Përshkrim i ngjarjes; Viktima 86/06, Formulari i Kërkesës; Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 41, 44-46, 49, 51; Shtojcat 2-7, 10, 12, 16-18, 20-22 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁸⁷ Viktima 78/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 80/06, Formulari i Kërkesës.

⁸⁸ Viktima 85/06, Formulari i Kërkesës; SD4-Dokumenti i Pronës; SD6-Shënim në dosje; Viktima 86/06, Formulari i Kërkesës. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se ZPV-ja nuk ka paraqitur përkthimin në anglishte të dokumentit të pronës dhe rrjedhimisht ai nuk ka mundur ta shqyrtojë këtë dokument.

⁸⁹ Viktima 70/06, Formulari i Kërkesës; SD2-Recetë nga mjeku; Viktima 71/06, Formulari i Kërkesës; SD3-Photo; SD4-Dokumentacion mjekësor; Viktima 73/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 76/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 82/06, Formulari i Kërkesës; SD3-Vërtetim mjekësor; Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 42-43, 45, 48, 50; Shtojca 8-9, 11, 14, 19 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁹⁰ Viktima 71/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 76/06, Formulari i Kërkesës; Viktima 82/06, Formulari i Kërkesës; SD4-Kërkesë pronësore dhe për banim; SD5-Vendim për dhënien në shfrytëzim të banesës; Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 43, 48, 50; Shtojcat 9, 14, 19 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

viktima 70/06 pretendon gjithashtu dëm material, por për arsye se shtëpia e tij u shkatërrua pas luftës dhe pa ndonjë lidhje të dukshme me akuzat në Aktakuzën e Ndryshuar,⁹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nuk ka lidhje të mjaftueshme të drejtpërdrejtë midis dëmit material dhe krimeve të paraqitura në akuza. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktima 82/06 pretendon dëm shtesë fizik ⁹² (vuajtje neurologjike, hipertension dhe diabet) si viktimë e drejtpërdrejtë, por gjykon se informacioni dhe dokumentacioni i dhënë nuk mjaftojnë për konstatim *prima facie* se dëmi fizik i përshkruar që pësoi viktima 82/06 është rezultat i drejtpërdrejtë i dëmit që iu shkaktua atij.

- (c) **Viktima 75/06** ka pësuar dëm mendor (traumë psikologjike dhe zemërim) si rezultat i drejtpërdrejtë i ndalimit dhe keqtrajtimit të pretenduar të tij.⁹³
- (d) **Viktima 77/06** ka pësuar dëm mendor (traumë psikologjike dhe frikë) për shkak të lidhjes së ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë.⁹⁴ Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake qartëson se, ndonëse lidhja e ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë nuk mund të prezumohet (sepse viktima 77/06 nuk është anëtar i familjes së ngushtë),⁹⁵ kjo lidhje mund të deduktohet prej faktit se ai është [REDAKTUAR].⁹⁶

45. Konstatimet e mësipërme nuk paragjykojnë asnjë vendim të ardhshëm pas parashtrimit të materialit shtesë.

⁹¹ Viktima 70/06, Formulari i Kërkesës; Shtojca 8 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁹² Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktima 82/06 i ka përmendur si dëme si mendore, por ai i konsideron dëme fizike.

⁹³ Viktima 75/06, Formulari i Kërkesës; Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 47; Shtojca 13 e Raportit të Pestë i Zyrës Administrative.

⁹⁴ Viktima 77/07, Formulari i Kërkesës; Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 46; Shtojca 15 e Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

⁹⁵ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50.

⁹⁶ Viktima 77/07, Formulari i Kërkesës.

3. Përfundim

46. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ka prova *prima facie* se viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 70/06, 71/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 82/06, 84/06, 85/06 dhe 86/06 kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të pretenduara në Aktakuzën e Ndryshuar dhe i pranon ata si viktima pjesëmarrëse në proces.

47. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton gjithashtu se viktimat 24/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06, për arsytet e paraqitura në paragrafin 42, nuk pranohen si viktima pjesëmarrëse në proces.

C. MASAT MBROJTËSE

1. Parashtruesit e kërkesave të pranuar

48. ZPV-ja rekomandon që të gjithë parashtruesve të kërkesave të pranuar për pjesëmarrje si viktimë në proces t'u miratohet anonimitet në pajtim me rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores.⁹⁷

49. Mbrojtja e Veselit e kundërshton këtë rekomandim, duke argumentuar se ZPV-ja nuk ka kryer vlerësimin rast pas rasti për secilën prej viktimave.⁹⁸ Ajo parashtron se kjo qasje është në kundërshtim të plotë me kërkesat e ZPS-së për masa mbrojtëse në lidhje me dëshmitarët.⁹⁹ Mbrojtja e Veselit argumenton gjithashtu se masat mbrojtëse që kërkohen nuk mbështeten në fakte, meqë shumë prej viktimave nuk kanë kërkuar anonimitet dhe nuk ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme, dhe, sido që të jetë, frika subjektive e viktimave individuale nuk mjafton për të peshuar më shumë se e drejta e të akuzuarve për gjykim të drejtë.¹⁰⁰

⁹⁷ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 69-70.

⁹⁸ Përgjigjja e Veselit, para. 7-8 e i referohet rregullës 80 të Rregullores dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123 ("KPP") të përcaktuara në nenin 23(1) të Ligjit.

⁹⁹ Përgjigjja e Veselit, para. 7.

¹⁰⁰ Përgjigjja e Veselit, para. 10-12 i referohet nenit 224(3) të KPP-së.

Së fundi, Mbrojtja e Veselit parashtron se rekomandimi i ZPV-së nuk është proporcional në lidhje me të drejtat e të akuzuarve.¹⁰¹

50. Sa i përket kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për seancë,¹⁰² Gjykatësi i Procedurës Paraprake i referohet së pari rregullës 80(4) të Rregullores, që përcakton se ai mund të mbajë seancë *in camera* për marrjen e vendimit nëse do të urdhërojë masa mbrojtëse, por nuk është i detyruar ta bëjë këtë. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake refuzon kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për seancë.

51. Së dyti, sa i përket argumentit të Mbrojtjes së Veselit lidhur me paligjshmërinë e anonimitetit,¹⁰³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij të mëparshëm në Vendimin e Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave se masa mbrojtëse e anonimitetit parashikohet sipas Rregullores,¹⁰⁴ që u konfirmua nga Gjykata e Apelit.¹⁰⁵

52. Së treti, në kundërshtim me pretendimin e Mbrojtjes së Veselit,¹⁰⁶ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative mbështetet nga shtojca më vete për secilin parashtrues kërkesë, që përmbajnë vlerësime të hollësishme të rrezikut.¹⁰⁷

53. Së katërti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se rekomandimet e ZPV-së përputhen me kërkesat e të gjithë parashtruesve të kërkesave të pranuar, me përjashtim të dy parashtruesve.¹⁰⁸ Sidoqoftë, ai thekson se, në pajtim me rregullat 80, 113(2) dhe (5) të Rregullores, ZPV-ja bën rekomandime në lidhje me kërkesat e parashtruesve për masa mbrojtëse, nëse është e nevojshme, për

¹⁰¹ Përgjigjja e Veselit, para. 10, 13.

¹⁰² Përgjigjja e Veselit, para. 10 e i referohet nenit 224(4) të KPP-së..

¹⁰³ Përgjigjja e Veselit, para. 5.

¹⁰⁴ *Shih* Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 36-41.

¹⁰⁵ Vendim i Gjykatës së Apelit mbi Masa Mbrojtëse, para. 32.

¹⁰⁶ Përgjigjja e Veselit, para. 7-8.

¹⁰⁷ Shtojcat 2-26 të Raportit të Pestë të Zyrës Administrative.

¹⁰⁸ Viktima 71/06 nuk ka kërkuar masa mbrojtëse dhe Viktima 82/06 kërkoi mosnxjerrjen për publikun të informacionit identifikues. *Shih* Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 67.

mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e tyre.¹⁰⁹ As në Ligj, as në Rregullore nuk përcaktohet se ZPV-ja nuk mund të bëjë rekomandime për masa mbrojtëse, përveç atyre që kërkohen nga viktimat pjesëmarrëse në proces, në qoftë se ZPV-ja gjykon se ato masa mbrojtëse janë të domosdoshme dhe proporcionale në rrethana. Krahas kësaj, kur viktimat dorëzojnë formularin e kërkesës, ata mund të mos e kuptojnë shkallën dhe pasojat e situatës së tyre të sigurisë. Rrjedhimisht, është detyrë e Gjykatësit të Procedurës që, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, të sigurojë që pjesëmarrja e viktimave të bëhet në mënyrë të mbrojtur dhe të sigurt.¹¹⁰

54. Së fundi, ndonëse Mbrojtja e Veselit argumenton se masa mbrojtëse e anonimitetit cenon të akuzuarit, sepse shkel parimin e procesit publik dhe “të drejtën për t’u ballafaquar me dëshmitarët gjatë procesit”,¹¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se duket sikur Mbrojtja e Veselit ngatërron statusin e dëshmitarëve me atë të viktimave pjesëmarrëse. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se qëllimi i pjesëmarrjes së viktimave në proces është që të përfaqësohen interesat e tyre personale,¹¹² dhe se viktimat pjesëmarrëse nuk janë dëshmitarë që inkriminojnë të akuzuarit dhe nuk paraqesin akuza.¹¹³ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se pjesëmarrja e viktimave në proces është objekt i kontrollit gjyqësor.¹¹⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje gjithashtu se kërkesa për nxjerrjen e kodeve të dëshmitarëve të viktimave pjesëmarrëse që janë edhe dëshmitarë të ZPS-së (ku masa mbrojtëse e anonimitetit mund të ndikojë në të drejtën e të akuzuarit për t’u ballafaquar me dëshmitarë)

¹⁰⁹ *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë Kornizë, para. 45, 49.

¹¹⁰ *Shih* nenet 23(1), 39(11) të Ligjit; rregulla 80(1) e Rregullores.

¹¹¹ Përgjigjja e Veselit, para. 10.

¹¹² *Shih* nenin 22(3) të Ligjit; rregulla 114(2) e Rregullores; *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 67; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38.

¹¹³ *Shih* rregullën 2 të Rregullores që përkufizon viktimën si “personi fizik që ka pësuar personalisht dëm fizik, mendor apo material si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprë penale që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.”; *Shih gjithashtu* neni 22(1) i Ligjit.

¹¹⁴ *Shih* rregulla 114(2) e Rregullores.

është ende në shqyrtim nga ai dhe do të trajtohet në kontekst të atij kontestimi juridik.¹¹⁵ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se masat mbrojtëse që kërkohen, në vetvete, nuk cenojnë të drejtat e të akuzuarve.

55. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hedh poshtë parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit dhe do të vazhdojë me shqyrtimin e kërkesës së ZPV-së për masa mbrojtëse.

(a) Formularët e kërkesave

56. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës mbesin rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

(b) Identitetet e parashtruesve të kërkesave

57. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, sikurse theksohet në Vendimin e Parë Kornizë, standardi ligjor që zbatohet për masa mbrojtëse në lidhje me viktimat është i njëjti standard që zbatohet në lidhje me dëshmitarët.¹¹⁶

58. Gjatë shqyrtimit të ekzistencës së rrezikut objektivisht të arsyeshëm dhe domosdoshmërisë së masave mbrojtëse për parashtruesit e kërkesave të miratuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktorët konkretë vijues që vlejnë për një apo më shumë viktime: (i) të gjitha viktimat vazhdojnë të vuajnë nga trauma fizike dhe/ose mendore si rezultat i krimeve, viktimë e të cilave pretendohet se kanë qenë ata ose familjarët e tyre;¹¹⁷ (ii) të gjithë parashtruesit e

¹¹⁵ *Shih* KSC-BC-2020-06, F00706, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë* (“Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë”), 21 shkurt 2022, publik.

¹¹⁶ Vendimi i Parë Kornizë, para. 47; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 67; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50; Vendimi i Tretë për Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 42.

¹¹⁷ *Shih më lart*, para. 44.

kërkesave, me përjashtim të dy prej tyre, kanë shprehur shqetësimin se nxjerrja e identiteteve të tyre për publikun, mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit mund t'i rrezikojë ata ose familjet e tyre;¹¹⁸ dhe (iii) [REDAKTUAR].¹¹⁹

59. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh: (i) atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe viktimave që mbizotëron në Kosovë, sidomos në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së;¹²⁰ dhe (ii) mjetet dhe motivet e të akuzuarve për t'i frikësuar viktimat, duke marrë parasysh postet me pushtet që kanë mbajtur gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat, si dhe kohët e fundit.¹²¹ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se: (i) për shkak të statusit të tyre si viktimë pjesëmarrëse në proces, këta individë janë veçanërisht të cenueshëm dhe çdo masë mbrojtëse duhet t'u përgjigjet nevojave të tyre të veçanta si viktimë; dhe (ii) masat adekuate mbrojtëse për viktimat shpesh janë mjete juridik përmes të cilit mund të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proces, sepse masa të tilla janë një hap i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e viktimave në pajtim me rregullën 80 të Rregullores.¹²²

60. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se nxjerrja për publikun dhe për palët e çdo materiali apo informacioni që çon në identifikimin e viktimave të pranuar për pjesëmarrje në proces përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për ta dhe për familjarët e tyre dhe, rrjedhimisht, konstaton se në këtë fazë të procesit anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është masa më e përshtatshme dhe e domosdoshme.

¹¹⁸ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 67; dhe formularët e kërkesës të secilës prej viktimave.

¹¹⁹ [REDAKTUAR].

¹²⁰ *Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06, IA015/F00005, Gjykata e Apelit, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Mbajtjes në Paraburgim*, 25 mars 2022, publik, para. 43.

¹²¹ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 51; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43.

¹²² *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 51; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43.

61. Sa i takon proporcionalitetit të këtyre masave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij më lart¹²³ dhe vë në dukje gjithashtu se: (i) çdo masë mbrojtëse e urdhëruar në këtë fazë në lidhje me një viktimë pjesëmarrëse të pranuar, nuk pengon ndryshimin e masave të tilla në një fazë të mëvonshme, përfshirë edhe nga trupi gjykues, nëse lind nevoja dhe kur të lindë kjo nevojë;¹²⁴ (ii) pjesëmarrja e viktimave në proces në fazën e procedurës paraprake është e kufizuar dhe rrjedhimisht ka ndikim të kufizuar në të drejtat e të akuzuarve; dhe (iii) masat mbrojtëse të miratuara në këtë fazë nuk pengojnë masa shtesë që lindin nga statusi i mundshëm i dyfishtë i viktimës, çështje kjo që është në shqyrtim prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe të cilën ai do ta trajtojë në kontekst të atij kontestimi juridik.¹²⁵ Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në këtë fazë të procesit, anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është një masë proporcionale.

62. Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emrat dhe të dhënat identifikuese të të gjitha viktimave të mos u bëhen të ditura publikut dhe palëve.

2.Parashtruesit e kërkesave të refuzuara

63. Sa u përket viktimave 23/06, 24/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06, 69/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se nisur nga konfidencialiteti i procesit të paraqitjes së kërkesave, siç përcaktohet në rregullën 113(1)-(2) të Rregullores, dhe duke mbajtur parasysh mbrojtjen e privatësisë së parashtruesve të kërkesave,

¹²³ *Shih më lart*, para. 54.

¹²⁴ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 69; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 53; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 45.

¹²⁵ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 67; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 40; *Shih gjithashtu* Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë.

është e domosdoshme që emrat dhe të dhënat identifikuese të tyre të mos nxirren për palët dhe publikun. Duke pasur parasysh se asnjë prej parashtruesve të kërkesave nuk është pranuar si viktimë pjesëmarrëse në proces, mosnxjerrja e të dhënave nuk cenon të akuzuarit apo gjykimin e drejtë.

64. Bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emrat dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimave 23/06, 24/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06, 69/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06 të mos nxirren për palët dhe publikun dhe, për rrjedhojë, e gjykon të përshtatshme ruajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të formularëve të kërkesave, përmbledhjeve dhe dokumentacionit mbështetës përkatës.

D. GRUPIMI DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR I PËRBASHKËT

65. ZPV-ja ka identifikuar një parashtrues kërkesë, rrethanat e të cilit mund të çojnë në konflikt të mundshëm interesi.¹²⁶ Megjithatë, ZPV-ja parashtron se ka analizuar hollësisht rrethanat individuale të parashtruesit të kërkesës dhe ndikimin e tyre mbi grupin në përgjithësi, dhe se një rrethanë e ngjashme u shqyrtua në lidhje me një parashtrues tjetër kërkesë dhe u vlerësua se nuk përbënte konflikt interesi që do të përlligjte krijimin e një grupi tjetër.¹²⁷ Rrjedhimisht, ZPV-ja rekomandon që të gjithë parashtruesit e kërkesave të miratuara të grupohen bashkë me viktimat e tjera të pranuar për pjesëmarrje në proces dhe që të përfaqësohen bashkërisht si një grup ("Grupi 1").¹²⁸

¹²⁶ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 62.

¹²⁷ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 62; [REDAKTUAR]; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00241, ZPV, *Shtesë e Raportit të Parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces me Rekomandim për Grupim*, 1 prill 2021, publike, para. 25-26, me një Shtojcë, konfidenciale dhe *ex parte*; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 73, 77.

¹²⁸ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 63.

66. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se viktimat përkatëse, që ZPV-ja thotë se ishte [REDAKTUAR] dhe që më lart u vlerësua se rrethanat e viktimës nuk përbënin konflikt interesi,¹²⁹ nuk është pranuar asnjëherë si viktimë pjesëmarrëse në proces.¹³⁰ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka shqyrtuar më parë nëse pranimi i një [REDAKTUAR] në Grupin 1 përbën konflikt interesi.

67. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, [REDAKTUAR], gjithashtu pësoi dëm si pasojë e krimeve të ngjashme me ato të pretenduara nga viktimat në Grupin 1, nga i njëjti grup kryesish dhe [REDAKTUAR] ka [REDAKTUAR].¹³¹ Rrjedhimisht, [REDAKTUAR] dhe Grupi 1 duket se kanë interes të përbashkët për pjesëmarrje në proces dhe për kërkim të të drejtave të tyre.

68. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se tri viktimat (viktimat 70/06, 75/06 dhe 76/06) kanë shprehur parapëlqimin të kenë një mbrojtës kompetent dhe besnik, një viktimë (viktimat 74/06) ka shprehur parapëlqim të përfaqësohet nga një mbrojtës joshqiptar dhe 17 viktimat nuk kanë ndonjë parapëlqim (viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 71/06, 72/06, 73/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 82/06, 84/06, 85/06, dhe 86/06).¹³²

69. Bazuar në të njëjtat konstatime si ato në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave,¹³³ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të gjitha viktimat e

¹²⁹ Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 62.

¹³⁰ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 47, 49; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 29-30.

¹³¹ [REDAKTUAR].

¹³² Raporti i Pestë i Zyrës Administrative, para. 65-66; dhe formularët e kërkesës për secilën prej viktimave.

¹³³ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76; *Shih gjithashtu* Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 58; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 48; Vendimi i Parë Kornizë, para. 43.

pranuara do të grupohen në Grupin 1, së bashku me viktimat e pranuar më parë dhe do të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave i caktuar për Grupin 1.

E. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

70. Viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 70/06, 71/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 82/06, 84/06, 85/06, dhe 86/06 do t'i ushtrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet mbrojtësit të viktimave dhe do të marrin pjesë në proces sipas modaliteteve të përshkruara në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave.¹³⁴

F. UDHËZIME PËR MBROJTËSIN E VIKTIMAVE

71. Duke pasur parasysh se së shpejti çështja do të kalojë në gjykim,¹³⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme që të ftojë mbrojtësin e viktimave të dorëzojë parashtrime shtesë me dokumentacionin mbështetës të përshtatshëm, nëse është e nevojshme, pasi ka konstatuar se nuk është dorëzuar dokumentacion i mjaftueshëm për konstatim *prima facie* të dëmit fizik dhe material që pretendojnë viktimat 78/06, 80/06, 82/06, 85/06 dhe 86/06.¹³⁶

G. ZGJATJA E AFATIT PËR LEJE PËR APELIM

72. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në pajtim me rregullën 77(1) të Rregullores, kur një palë kërkon të apelojë vendimin e një paneli që nuk është vetiu i apelueshëm, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim të ndërmjetëm panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda 7 (shtatë) ditësh

¹³⁴ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 82-84, 85(d).

¹³⁵ KSC-BC-2020-06, F01131, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Njoftim në përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*, 30 nëntor 2022, publik.

¹³⁶ *Shih më lart*, para. 44(a)-(b).

prej daljes së vendimit. Duke mbajtur parasysh pushimin e afërt dimëror të gjykatës,¹³⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme që, në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, të ndryshohet afati për kërkesën e lejes për apelimin e këtij vendimi. Rrjedhimisht, një kërkesë ose kërkesa të tilla duhet të dorëzohen jo më vonë se të **hënën, 9 janar 2023**. Çdo përgjigje dhe kundërpërgjigje përkatëse duhet të respektojë afatet e përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores.

VI. VENDIM

73. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesat e viktimave 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 70/06, 71/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 82/06, 84/06, 85/06 dhe 86/06 dhe i pranon si viktimë pjesëmarrëse në proces;
- b. **RRËZON** kërkesat e viktimave 23/06, 24/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06, 69/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06 si të papranueshme;
- c. **VENDOS** që viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 70/06, 71/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 82/06, 84/06, 85/06, dhe 86/06 të përfshihen në Grupin 1 me qëllim përfaqësimit e përbashkët dhe të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave për Grupin 1;
- d. **VENDOS** që mbrojtësi i viktimave:
 - i. ka të drejtë të shohë të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese, të

¹³⁷ Pushimi dimëror është nga e hëna, 19 dhjetor 2022, deri te premten 6 janar 2023, *shih* KSCPR-2021, F00002, Kryetarja, *Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2022*, 11 nëntor 2021, f. 2, publik.

- klasifikuara publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes;
- ii. ka të drejtë të njoftohet për të gjitha materialet e shpërndara në dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet, nxjerrjet e materialeve provuese të klasifikuara si publike apo konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të shpërndara të dosjes së çështjes;
 - iii. nuk ka të drejtë të shohë, as të njoftohet për materialet rreptësisht konfidenciale, përfshirë parashtrime të protokolluara, transkripte apo materiale provuese, nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe;
 - iv. të mbajë të informuar viktimat pjesëmarrëse në proces për zhvillimet përkatëse të çështjes në mënyrë të tillë që të mos zbulojë informacione jopublike;
 - v. të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*; dhe
 - vi. të lejohet të bëjë parashtrime gojarisht dhe me shkrim, pa kërkuar paraprakisht leje, sa herë që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces;
- e. **URDHËRON** që për viktimat 63/06, 64/06, 65/06, 66/06, 67/06, 68/06, 70/06, 71/06, 72/06, 73/06, 74/06, 75/06, 76/06, 77/06, 78/06, 79/06, 80/06, 82/06, 84/06, 85/06, dhe 86/06, të miratohet masa mbrojtëse e anonimitetit sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores;
- f. **URDHËRON** që emrat dhe të dhënat identifikuese të viktimave 23/06, 24/06, 29/06, 30/06, 31/06, 32/06, 42/06, 43/06, 48/06, 49/06, 50/06, 51/06, 52/06, 60/06, 61/06, 62/06, 69/06, 81/06, 83/06 dhe 87/06 të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut;

- g. **VENDOS** mbajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* për të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës;
- h. **FTON** mbrojtësin e viktimave që të dorëzojë parashtrime shtesë sikurse përcaktohet në paragrafin 71; dhe
- i. **NDRYSHON** afatin për çdo kërkesë të mundshme për leje për apelim të këtij vendimi dhe **URDHËRON** që kërkesa të tilla të dorëzohen deri të **hënën, 9 janar 2023**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 12 dhjetor 2022

Në Hagë, Holandë.